



SPECIFIKIME TEKNIKE

REHABILITIMI I SHKOLLES SE MESME BICAJ "BAJRAM ABDIU" KUKES



PRILL 2023

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: REHABILITIM I SHKOLLËS SË MESME BICAJ "BAJRAM ABDIU" KUKËS

1. KUSHTE TË PËRGJITHSHME

1.1. Pozicioni gjeografik i objektit, të dhënat e terrenit:

Gjimnazi ndodhet fshatin Canaj, në Jug të qytetit të Kukësit në njësinë Administrative Bicaj. Ndërtesa ndodhet në zonën kadastrale 2839 dhe pasuria me numër 47 dhe 48 me një sipërfaqe totale prej 10272 m² ku sipërfaqe ndërtese është prej 779m².

1.2. Përkatësia territoriale dhe pronësore

- Objekti ndodhet në qarkun e Kukësit, rrethi Kukës, Fshati Canaj, Njwsia Administrative Bicaj.
- Varësia administrativo-territoriale –Njësia Administrative Bicaj në Bashkinë Kukës
- Emërtesa –"Rehabilitim i shkollës së mesme Bicaj "Bajram Abdiu" Bicaj, Kukës.

1.3. Detyrimet e Kontraktorit (aspekti teknik i detyrimeve) Kontraktori kryesor (jo nënkontraktorët nëse ka) detyrohet:

a. Të zbatojë me përpikmëri projektin e ndërtimit duke plotësuar:

- të gjitha standartet shtetërore për punimet e ndërtimit
- të gjitha kushtet teknike të zbatimit të punimeve
- të gjitha standartet dhe cilësitë e materialeve të përcaktuara në projekt
- të gjitha testet laboratorike të përcaktuara sipas projektit apo që do të kërkohen më vonë
- të gjitha rregullat e përcaktuara për sigurimin teknik në punë për njerëzit dhe objektin
- kushtëzimet (specifikimet teknike)
- çmimet e tregut

Kuides: *Për cilësinë dhe standartet e materialeve të përcaktuara në projekt kontrolli do të jetë maksimal dhe toleranca zero*

b. Nuk do të lejohet fillimi i punimeve nga kontraktori nëse:

c. Nuk ka stafin e nevojshëm që duhet për zbatimin e objektit.

Nuk ka bërë njohjen, studimin dhe zbërthimin e projektit teknik nga stafi teknik i zbatimit dhe deklarimi nga administratori i kontraktorit (me shkrim) se zbatimi i objektit (ana teknike) garantohet.

1.4.1 Nuk lejohen ndryshime (përveçse të autorizuar me shkrim nga projektuesi) në projekt. Çdo devijim është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e zbatuesit.

1.4.2. Detajet, përmasat do të zbatohen vetëm ato të përcaktuara në vizatimet e projektit ose shenimet përkatëse në projekt. Nëse detaji është "tip" do të zbatohet njëjloj në të gjitha pjesët e konstruksionit ku është përcaktuar.

1.4.3. Gjatë verifikimit dhe studimit të vizatimeve nga personeli inxhinieriko-teknik i zbatimit, së bashku me fletët arkitektonike e kosntruktive (skeletit mbajtës) të studiohen njëherësh dhe fletët e rjetit inxhinierik (elektrik, ujsjelleës, kanalizime, kompjuterik, telefonik, sinjalizim) në mënyrë që të mos krijohen përplasje apo ndërfaqe kabllorsh telash etj.

1.4.4. Nëse ndodhin devijime apo shkelje të projektit gjatë zbatimit, përveç dokumentimit në librin e objektit, kontraktori është i detyruar të njoftojë me shkrim investitorin dhe të nderprejë menjëherë punimet.

1.4.5. Të gjitha kostot e ngritjes së kantierit, mirë mbajtjen e sheshit gjatë ndërtimit dhe pastrimin e tij në mbarim të punimeve, janë në çmimin e tenderit.

1.4.6. Gjithë dokumentacioni teknik i zbatimit të objektit (projekti ku janë pasqyruar të gjitha ndryshimet që mund të kenë ndodhur), çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, testet laboratorike të materialeve, proces-verbalet e testeve me ngarkesë të elementëve të konstruksionit, libri i objektit ngadatat e fillimit të punimeve e deri në ditën e kolaudimit, janë pronë e investitorit (pronarit) dhe i dorëzohen atij. Çdo njëri nga këto dokumente do të ketë nënshkrimet dhe vulën e sipërmarrësit.

2. BETONI (MONOLIT- DERDHUR NË VEND)

2.1. KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR BETONET

Betonet që do të përdoren në këtë objekt janë mbi 95% të sasisë në konstruksionin mbajtës (plinta, trarë, kollona, soleta) të ndërtesës.

2.1.1. Markat (rezistenca prizmatike në shtypje pas 28 ditëve ngurtësim) që do të përdoren janë : N/shtresa M-100 ; Plinta, Trarë, Kollona M-250 ; Mure betoni M-150 ; Soleta M-250.

2.1.2. Betonet nuk do të prodhohen në kantier (objekt) por do të blihen të prodhuar nga të tretë (fabrika betoni). Çdo furnizim të shqerohet me çertifikate ku cilesohet marka e betonit e cila verifikohet përfundimisht nga laboratore të licensuar pas 28 ditësh nga hedhja në veper sipas kampioneve të mbajtura në veper.

2.1.3. Të gjitha betonet në çdo rast do të prodhohen në bazë të standartit.

2.1.4. Prodhimi i betoneve do të fillojë vetëm pasi të jenë siguruar çertifikatat e cilësisë (prodhuesi, laboratore të akredituara nga DPS – Drejtoria e Përgjithshme e Standarteve). Për betonet e blera çertifikatat do t'i merren prodhuesit.

2.1.5. Në vazhdimësi të zbatimit të punimeve, për të gjitha elementet (plinta, kollona, trarë, soleta) gjatë hedhjes në veper (betonimit) do të mbahen kampione (kubik) të cilat do të nënshtrihen provave laboratorike 7 dhe 28 ditëshe. Çertifikatat e laboratorëve të akredituara nga DPS do të administrohen nga supervizori në dosjen e objektit dhe në përfundim i dorëzohen investitorit, i cili i bashkangjet me dokumentacionin e pasurisë së pa-luajtshme.

2.1.6 Nëse në ndonjë rast, për ndonjë element, marka e betonit (MB) e provuar në laborator pas 28 ditëve (R28) rezulton më e vogël se ajo e projektit për atë element, elementi do të shkatërrohet dhe do të ribetonohet. Paralelisht njoftohet projektuesi, investitori dhe instanca të tjera sipas ligjit.

2.1.7. Nga fillimi deri në përfundimin e konstruksionit mbajtës të ndërtesës, të drejtë ekskluzive për kontrole, sanksione e penalitete veç investitorit (nëpërmjet supervizionit) kanë në vazhdimësi projektuesi strukturat e saja në vendin ku ndërtohet objekti.

2.1.8 Ndryshimi i markave të betonit të përcaktuara në projekt në asnjë rast nuk është objekt negociimi. Markat mund t'i ndryshojë vetëm projektuesi duke bërë shënime në projekt etj. në rrugë ligjore.

2.2. MATERIALET PËRBËRËS TË BETONEVE

2.2.1 Çimentoja që do të përdoret për të gjithë elementët do të jetë sipas STASH 503-73 që është konform standartit europian EN 197-1.

2.2.2. Konkretisht sipas standarteve të mësipërme do të mund të përdoren:

- Prodhim shqiptar - Çimento Portland tipi CEM / B-M, klasa 42.5R që i përgjigjet M-400 të çimentos. Rezistenca me shtypje 28 ditore 40.8 MPa dhe në përkulje 7.84 MPa.
- Ose çimento importi e çertifikuar sipas standartit europian (nga Italia, Greqia etj.) të markës R-42.5 N/mm².

2.2.3. Në të gjitha rastet çimento që futet në kantier për të prodhuar betone, duhet të shoqërohet me certifikatën e provës laboratorike para përdorimit. Nëse nuk plotëson parametrat sipas 3.2.2. refuzohet nga kantieri duke sjellë çimento tjetër. Provat sipas STASH 501-87, 503-87 bëhen në laboratore të akredituara nga DPS (Drejtoria e Përgjithshme e Standarteve).

2.2.4. Inertet (përbërësit e betonit) përcaktohen në bazë të markave në bazë të STASH 504-505-73. Për betonet që do të prodhohen në këtë objekt në bazë të këtyre standarteve dhe K.T. 37-75, më poshtë jepen në formë tabelash të dhënat:

- Marka, Konsistenca, Moduli i rërës, Sasia e çimentos, rërës, zallit, ujit në funksion të madhësisë të kokrrave në mm. (tabelat faqe 35-48 broshura K.T.37-75).

2.3. DOZIMI I PËRBËRËSVE SIPAS MARKAVE

2.3.1. Beton M-100 do të përdoret vetëm për shtresat në katin .
përdoret çimento M-300 (32.5N/mm²) – 240 kg/m³
- zhavor 1.13 m³/m³
- ujë 170-200 l/m³.

2.3.2. Beton M-150 do të përdoret për themel, mure betoni (bodrum) .
. Do të prodhohen me konsistencë 3-5cm me dozat:
- çimento M-400, në sasi – 260 kg/m³
- rërë e larë (moduli 2.6) – 0.48 m³/m³
- granile (- 20mm) – 0.77m³/m³
- ujë: 180 l/m³
- raporti ujë-çimento – 0.69

2.3.3. Betone M-200. Do të përdoret për trarë kollona.
Do të prodhohet me konsistencë 3-5 cm me dozat:
- çimento M-400 në sasi – 300 Kg/m³
- rërë të larë (moduli 2.6) – 0.47m³/m³
- granile (-20mm) – 0.75m³/m³
- ujë – 180 l/m³
- raporti ujë-çimento – 0.6

2.2.2. Konkretisht sipas standarteve të mësipërme do të mund të përdoren:

- Prodhim shqiptar (FKCF) - Çimento Portland tipi CEM / B-M, klasa 42.5R që i përgjigjet M-400 të çimentos. Rezistenca me shtypje 28 ditore 40.8 MPa dhe në përkulje 7.84 MPa.
- Ose çimento importi e çertifikuar sipas standartit europian (nga Italia, Greqia etj.) të markës R-42.5 N/mm².

2.2.3. Në të gjitha rastet çimento që futet në kantier për të prodhuar betone, duhet të shoqërohet me çertifikatën e provës laboratorike para përdorimit. Nëse nuk plotëson parametrat sipas 3.2.2. refuzohet nga kantieri duke sjellë çimento tjetër. Provat sipas STASH 501-87, 503-87 bëhen në laboratore të akredituara nga DPS.

2.2.4. Inertet (përbërësit e betonit) përcaktohen në bazë të markave në bazë të STASH 504-505-73. Për betonet që do të prodhohen në këtë objekt në bazë të këtyre standarteve dhe K.T. 37-75, më poshtë jepen në formë tabelash të dhënat:

- Marka, Konsistenca, Moduli i rërës, Sasia e çimentos, rërës, zallit, ujit në funksion të madhësisë të kokrrave në mm.

2.4. PROCESI I BETONIMITI NË OBJEKT

2.4.1. Sipas projektit ka këto kushtëzime:

- transporti vertikal me mjete elektro-mekanike (elektro vinça stacionuar/fiks ose auto-hedhës),
- vibrimi shumë i mirë me vibrator thellësisë apo sipërfaqësor, sipas llojit të elementit, kusht themelor për arritjen e markës së projektuar të betonit.
- koha për përgatitjen, transportimin, hedhjen dhe vibrimin e betonit, në funksion të markës duhet detyrimisht dhe në çdo rast të jetë më e vogël se koha e prezës së betonit.

2.4.2 Procesi i betonimit të grup elementëve apo elementit shoqërohet me dokumentacion të veçantë:

- a. Bëhet proces-verbal i veçantë (zbatues-supervizor) ku cilësohet ora e fillimit dhe përfundimit të betonimit, elementet e betonuar, sasia e betonit të hedhur, marka e betonit, temperatura e ajrit (nëse ka mundësi dhe lagështia e ajrit).prodhuesi,ora e furnizimit dhe marka sipas shitesit.
- b. Në librin e objektit cilësohen me shkrim dhe bashkangjiten çertifikatat e cilësive së materialeve të përdorura.
- c. Cilësohen (numërtohen e datohen) kampionet e betonit (kubikët) për provat laboratorike duke bërë proces-verbal të veçantë, nga një copë (kubik) për çdo kampion mbahen nën administrim të supervizorit në zyrën e tij deri në marrjen e përgjigjes zyrtare nga laboratore të akredituar për kryerjen e provave.

2.4.3. Nuk lejohet ndërprerja e betonit të elementëve. Ata do të betonohen njëherësh të plotë (trau, kollona, plinti, soleta) ashtu siç dhe janë llogaritur të punojnë.

2.4.4. Kur ka dyshime (supervizori apo struktura të tjera) për aftësinë mbajtëse të elementit të betonuar bëhet prova e faktit me ngarkesën e llogaritur në objekt (pavarësisht nga çertifikata e testit laboratorik).

2.5. MBROJTJA E BETONIT

2.5.1. Për funksionimin normal të konstruksionit dhe jetëgjatësinë e tij në tërësi dhe elementëve të veçantë realizohet mbrojtja gjatë formimit (beton i freskët i hedhur me beton forme) dhe gjatë shfrytëzimit.

2.5.2. Betoni i freskët duhet të mbrohet nga këto ndikime:

- lagështia e tepërt (shiu, etj) duke mbuluar sipërfaqen e elementit të derdhur me fletë plastmase apo materiale të tjera të padepërtueshme nga uji.
- temperaturat e ulëta; duke mos kryer betonime në temperaturë < 4⁰ C, ose për të bërë betonime deri afër 0⁰ C duke shtuar kimikatet (solucione) kundër temperaturave të ulëta.

- temperaturat e larta; duke ndërprerë betonimin kur temperaturat dhe lagështia e ajrit janë jashtë kushteve optimale për procesin e ngurtësimit, ose duke organizuar lagjen e betonit (pasi të ketë bërë prezen) çdo 6-7 orë për 5 deri 7 ditë.

3. METALET QË PËRDOREN NË OBJEKT

3.1. Metalet që përdoren në konstruksione:

- hekuri i betonit (çelik i butë) marka sipas përcaktimit në projekt.
- produkte duro-alumini të profiluar për dyer, dritare, parapete shkallë e ballkone
- llamarina çeliku të petëzuara (detaje të ndryshme)
- llamarina çeliku të profiluara – konstruksioni i çatisë, shkallet e avarise etj.

3.1.1. Hekuri i betonit

- për të gjitha strukturat b/arme të objektit do të përdoren hekur periodik (diametri nominal 8-22mm), duhet të jenë të paisur me certifikatën e cilësisë

2. Furnizimi nga Blerësi

- hekuri i furnizuar pranohet në kantier vetëm me certifikatë cilësie (çdo furnizim).
- hekuri i furnizuar vihet në punë vetëm pasi të jenë bërë provat e kampioneve në laborator të akredituar.
- nuk lejohet pranimi dhe vënia në punë e hekurit me ndryshk (oksid hekuri)
- në mënyrë kategorike nuk lejohet ripërdorimi i hekurit të përdorur më parë.

3.1.3. Depozitimi i hekurit në kantier

- hekuri i furnizuar në kantier depozitohet në ambiente të mbrojtura nga shiu apo ndotës të tjerë
- nëse sipërmarrësi nuk ka kantier të veçantë (nyje përpunimi hekuri) ose ky kantier është larg objektit, kushtet për përpunimin e hekurit për çdo element krijohen në sheshin ku ndërtohet objekti.

3.1.4. Përpunimi i hekurit (përgatitja për elementët konstruktiv)

- hekuri për çdo element në sasi, diametër dhe gjatësi përgatitet vetëm sipas përcaktimeve të projektit.
- bashkimi në të nxehtë i hekurit punues nuk lejohet .
- prerja bëhet vetëm me makina prerëse apo gur fresibël. Nuk lejohet prerja me oksigjen apo elektrogjen .

3.1.5. Vendosja dhe fiksimi në beton-formë

- pas fiksimit të shufrave punuese e konstruktive, kontrollit me përcaktimet në projekt për lloje dhe sasi, skeleti i përgatitur pastrohet, lahet me ujë dhe pastaj fiksohet brenda beton formës
- lidhja e shufrave me stafat realizohet me pikatriçe ose tel çeliku 1.25 m (i djegur – tel bari)
- nëse në element ka detaje të tjera, pllaka metalike, tuba hekuri për bira etj. ato fiksohen në beton formë pasi të jetë vendosur armature e hekurit.
- vetëm pasi të bëhen të gjitha verifikimet sipas projektit dhe kontrollohen masat e sigurimit teknik, bëhet lagia e beton-formës dhe armaturës së hekurit dhe fillon procesi I betonimit.

3.1.6. Garantimi i punë së hekurit në element ose ndryshe “mbulimi i hekurit”

1. Minimumi i pastër i shtresës mbrojtëse të betonit (përcaktohet në projekt për çdo element) nga faqet e përfunduara të betonit (devijimi i lejuar +/- 2mm)
2. Distance e fiksuar në projekt mes akseve të shufrave punuese duhen respektuar rigorozisht.
3. Zgjatimi i shufrave të hekurit mund të bëhet vetëm sipas përcaktimeve në projekt.

3.1.7. Lllamarina çeliku dhe profile, tubat

- do të përdoren prodhime importi, kryesisht në konstruksionin e çatisë e detaje të tjera
- profilet e importuara do të përdoren të standarteve të prodhimit perëndimor:
- llamarina e çelikut për panelet e mbulesës prodhim sipas standartit european EN 10142 dhe EN 10147
- tubat që do të përdoren do të jenë tuba:
 - për ujin e pijshëm, hekuri të xinguar standarti DIN 2440 dhe/ose ISO/DIS 65
 - për kaldajen
 - për detaje

3.1.8. Mbrojtja e Elementëve

Të gjitha pjesët e zbuluara metalike (përjashtuar atyre të futura në beton dhe panelet sandëvich, tubat xingat) do të mbrohen nga agjentët atmosferikë e faktorët e jashtëm konkretisht: (në detaje kap.7 K.T.Z. 21-80):

- Pjesët që do të zhyten në beton lyhen me lëng çimento
 - Para bojatisjes konstruksioni metalik pastrohet deri në shkëlqim me rërë kuarci ose furçe metalike
 - Për elementë që nuk montohen në lartësi, lysterja bëhet:
- Një dorë bojë minjo (anti ndryshk)
 - Dy duar bojë antiruxho (sipas ngjyrës së përcaktuar)

3.1.10. Metali (Duro-Alumin) që do të përdoret për dyer/dritare do të jetë sipas standartit. Këta elementë nuk prodhohen nga sipërmarrësi por në nyje të specializuara për këto prodhime.

4. RIFINITURAT E MUREVE, VESHJE, LYERJE

Të gjitha muret sipas projektit do të suvatohen nga të dy anët.

4.1.0. Standartet e materialeve përbërës dhe market e llaceve do të jenë ato të përshkruara nga projektuesi ne projekt.

4.1.1. Suvatimet e brendshme do të realizohen me llac bastard M-25.

4.1.2. Në pjesën dërmuese të suvatimeve të brendshme do të bëhet patinimi me allci.

- allcia duhet të plotësojë standartin të jetë e cilësisë së parë
- para patinimit sipërfaqja e suvasë duhet të kontrollohet, te jetë e rrafshhtë, të laget me ujë
- trashësia e patinimit është 2-3 mm
- hidhet, rrafshohet me mallë plastike, pastaj llustrohet me mistri metalike

4.1.3. Suvatimet e Jashtme

Marka e llacit të suvatimit dhe lloji përcaktohen në projekt dhe cilesohet ne preventiv.

4.2. Veshja me pllaka majolike

4.2.1. Kjo veshje do të zbatohet në nyjet h/sanitare në sasi të përcaktuara në projekt

Cilësia e pllakave do të jetë e parë (STASH 532-61, korrektuar për pllaka importi)

Ngjyra do të përcaktohet nga investitori/projektuesi.

Certifikata e cilësisë do të shoqërojë mallin e furnizuar.Pa çertifikate ndalohet fillimi i punes.

Pllakat vendosen pasi të jetë bërë më parë suvatimi i murit dhe kontrolli i tij.

Pllakat ngjiten në mur me koll pllakash për veshje. Para ngjitjes laget suvaja

4.3. Lyerjet

4.3.0. Do të lyhen: sipërfaqet e suvatuara dhe sipërfaqet metalike të ekspozuara.

4.4.1. Të gjitha muret (e paveshura) jashtë dhe brenda do të lyhen me bojë plastike
Përdoren bojra të standarteve të shoqëruara me çertifikate cilësie.

5. SHTRESAT

7.1. Sipas variantit të pranuar të projektit, shtresat në objekt do të jenë:

1. shtresa pllaka gres porcelanato për koridore holle.
2. shtresa pllaka qeramike me glazurë sipërfaqe të ashpër cilësia e parë spanjolle –Klasat laboratorit, zyra etj.
3. shtresa pllaka gres me sipërfaqe të ashpër – Hollet, koridoret, nyjet Hidro sanitare ambientet e shërbimit.
4. shtresa pllaka mermeri të bardhë/bezh – pragjet e dritareve, dyerve bazamakët e shkallëve
5. Shtresa pllaka graniti-Bazamakët e shkallëve të jashtme.

5.1.1. Kërkesat teknike të shtresave do t'i nënshtrohen standartit ndërsa materiali do të jetë i shoqëruar me certifikatë. Nxhyrat do të përcaktohen nga investitori.

5.1.2. Për të gjitha llojet e shtresave; gres, qeramik, granit, mermer, ngjitja do të realizohet me koll, jo me llac. Llaçi do të përdoret vetëm për pllakat e ganilit. Për korimantot pllakat bezh do të bashkohen me ngjites special për pllaka mermeri.

5.1.3. Pllakat (të gjitha llojet) do të futen në kantier vetëm pasi të jenë miratuar nga projektuesi dhe investitori në bazë të kampioneve të paraqitura më parë nga zbatuesi

5.1.4. Furnizimi do të bëhet një herë për çdo lloj për sasinë e kërkuar në projekt nga një parti malli. Furnizimi nuk pranohet në kantier pa certifikatë cilësie.

5.1.5. Marrja në dorëzim e punimeve bëhet nga investitori në vecanti për çdo lloj pllake të përdorur.

6. DYERT DHE DRITARET

Sipas projektit në objekt do të përdoren:

- Dritare duro-alumini cilësia e parë me dopje xham trashësi xhami 5mm në vettrat koridore e holle.
- Dritare në klasa, laborator, e ambiente të tjera D/AL cilësia e parë dopje xham trashësi 5mm. Nyjet H/Sanitare, baxho, dalje në atraca D/Al tek xham 5mm.
- Dritaret (vettrat) në shkallë e avarise do të jenë tek xham i armuar.
- Dyer duro-alumini me xham akulli në nyjet h/sanitare. Xhami 1/3 lartësi
- Dyer duro-alumini 2/3 xham në dalje në tarrace
- Dyer druri me kasë të plotë, hyrja kryesore e shkollës me sipërdrite
- Dyer tamburato me kompesat me kasë të plote druri (derrase pishe) hapje jashtë klasat
- Dyer tamburato me kompesat me kasë të plote druri (derrase pishe) hapje brenda zyrës
- Në katin përdehe zgarat metalike do të jenë me hekur katror 12x12 me konstrukcion profila

“U” dhe “L”

6.1. Përmasat e të gjitha dyerve dhe dritareve të objektit përcaktohen në projekt

6.1.1. Dyert, dritaret e të gjitha llojeve dhe aksesoret e nevojshëm për montimin e tyre nuk do të prodhohen nga sipërmarrësi por do të blihen nga prodhues të specializuar e licensuar për këto prodhime. Montimi të bëhet nga prodhuesi dhe dorezohet në prezencë të supervizorit.

6.1.2. Lëndët e para për prodhimin e tyre duhet të plotësojnë:

Duro-alumini (prodhim importi) të standartit ISO 9001 EN 573-3, prodhim italian, trashësia e paretëve të profilave -2mm (trashësia e paretëve dhe të dhëna të tjera sipas standartit të mësipërm specifikohen në kontratën e sipërmarrësit me prodhuesin).

Lënda e drurit për dyert e brendshme pishë dhe për dyert e hyrjes në objekt lis.

Lënda e drurit e sharruar për këto prodhime duhet të plotësojë standartet STASH 701-80 dhe 744-82 të jetë e cilësisë së parë në tre lloje (e hollë deri 30mm e trashësi mbi 30mm dhe binare)

6.1.3. Dyert e brendshme të ambienteve tamburato me kasë të plotë (trashësia e murit pa suva 25cm) sipas projektit paraparë të jenë të importuara dhe me brava sekrete. Të tjerat mund të prodhohen edhe në vend nëse plotësojnë standartet.

6.1.4. Të veçanta për dritaret

a. Të duro-aluminit

- Përmasat dhe nervaturat sipas përcaktimeve në projekt, të gjitha tek/dopjo xham

- lartësia nga kuota e mbaruar e dysheme 100cm

- trashësia e xhamit $t=5\text{mm}$

- ngjyra Gentian Blu (RAL 5010, M7301) mund të ndryshohet nga investitori

- hapje vertikale dhe horizontale në nyjet H/Sanitare e vetrata shkalles (të kombinuara), JO hapje me rrëshqitje. Hapja horizontale apo vertikale përcaktohet nga Investitori.

b. Qëllimi i përdorimit të dritareve me dopje zham metali (në ambientet e shfrytëzuara) është për rregullimin e regjimit termik të ambienteve, shmangien e lagështirës dhe akullit nga faqja e brendshme e dritareve të d/al.

6.1.5. Të veçanta për dyert

a. Të duro-aluminit

- do të jenë me 2/3 xham, $t=5\text{mm}$ (të jashtmet e ballkone dalje në tarrace

- 1/3 xham akulli (dyert e brendshme të nyjeve h/sanitare të katit perdhe dhe të parë

- hapësira dhe lartësia drite në projekt jepen për dysheme të papërfunduar dhe shpatulla të suvatuara

b. Të drurit

- të brendshme të ambienteve do të jenë druri tamburato kompensate me kasë të plotë 30cm (ngjyra përcaktohet nga investitori). Në klasa hapja nga jashtë.

- të brendshme në ambiente zyra etj do të jenë prej druri tamburato kompensate me kasë të plotë 30cm me hapje nga brenda.

c. Të drurit në hyrje të objektit

- kasë e plotë dru lisi

- kanata lisi (të hapshme dhe fikse)

- xham i armuar $t=6\text{mm}$

- nervaturat e drurit dhe xhami mbi $h=90\text{cm}$

- pjesa $h=90\text{cm}$ (kanatat, pjesët fikse sipërfaqe dru lisi e përpunuar (jo plane, e dekoruar)

6.2. Vendosija në vepër e dyerve dhe dritareve

Para tërheqjes së produkteve nga prodhimi, supervizori bën kontrollet e cilësisë së prodhimit dhe materialeve të përdorura duke konfirmuar pranimin ose jo. Prodhimet që refuzon supervizori nuk vihen në vepër.

Montimi në objekt bëhet:

- Dritaret: pasi të kenë përfunduar të gjitha punimet ndërtimore në anën e jashtme dhe të brendshme të mureve dhe të jenë vendosur pragjet e mermerit dhe shpatullat , përfunduar lyerjet dhe kontrolluar hapësirat e dritë faktike
- Dyert: përveç se sa për dritaret pasi të kenë përfunduar dhe shtresat e pllakave dhe vendosja e plintuseve deri në takim me fashaturat e dyerve.
- Montimi i dyrve dhe dritareve do te behet nga prodhuesi dhe kolaudohet e merren ne dorzim nga sipermarrsi ne prezence te supervizorit.

7. ÇATIA

7.1. Çatia e ndërtesës ka specifikat:

Konstruksioni mbajtës është kombinim beton dhe metal

H/izolimi arrihet nëpërmjet konstruksionit metalik

T/izolimi arrihet nëpërmjet , polistirenit ne panelet sanëich dhe soletes B/arme te katit.

Çatia nuk ka funksion te dyfishte,nuk eshte e shfrytezueshme prandaj ka pjerresi te vogel.

7.1.1. Materialet e konstruksionit

Betonet sipas markave të përcaktuara në projekt për këtë pjesë të konstruksionit do të plotësojnë kushtet e përcaktuara në kapitullin (3) të specifikimeve.

Metalet sipas parametrave dhe përmasave do të plotësojnë kushtet e përcaktuara në kapitullin (5) të specifikimeve.

Panele metalike mbulimi (me t/izolues polistiren) me material bazë llamarinë çeliku të standartit europian EN 10142 dhe EN 10147

- tipi i panelit që do të përdoret është sipas përcaktimit në projekt dhe preventiv.
- Se bashku me panelet do të furnizohen dhe ulluqet horizontal "U" me aksesore,Ulluqet Vertical katror me aksesoret dhe elementet e kulmit.
- Dalja në çati do të realizohet nga koridori i katit te dyte.

8. PUNIME TË NDRYSHME

Në këtë kapitull përfshihen punime me zëra të veçuar. Për këtë objekt veçohen:

8.1. Parapet shkalle (i kombinuar). Paraparete parete beton arme te holla me korimano mermeri beshe njeri variant dhe me tuba alumini varianti tjetër.Investitori vendos per variantin qe do te zbatohet.

8.1.1. Parapeti i shkallëve do të jetë i kombinuar metal/beton dhe pllaka graniti/mermeri

Lartesia me gjithë korimanon 1,1m

- tubat do të jenë d/alumini ose çelik i pa oksidueshëm të veshura me llak ngjyrë argjendi (ose ndryshe nëse kërkon investitori)

- mbërthimet do të bëhen me detajet e inkastruara me beton dhe lidhje me bulon e vida të detajeve .apo granitit/mermerit Per korimano me pllaka mermeri,pllakat do te ngjiten.

- graniti/mermeri do të jenë me t=20mm me sipërfaqe të përpunuar në të dy anët

- ngjyra e mermerit do te jete bezh si e bazamakëve. Nëse do të përdoret mermer do të jetë i bardhë pa dammar gri ose bezh e paster.

8.2. Pragjet e dritareve

- në të gjitha dritaret do të vendosen (në lartesi 100cm nga dyshemeja) pragje mermeri

- pragjet do të jenë me mermer të bardhë ("Kavalla") t=2cm me përpunime sipas detajit në projekt

- pragjet do të përbëhen nga dy pllaka që vendosen në nivele jo të njëjta me pjerresi 1,5% ne drejtim ngabrenda-jashte(Fasade). Duhet të largojnë të gjitha ujrat që vijnë nga faqja e dritares së jashtme dhe të mos lejojnë futjen e ujrave brenda

-Ne faqen e jashtme te murit ne dritare, vetrata shpatullat suvatohen shume mire me siperfaqe te lemuar dhe luhen me tre duar boje plastike..

8.3. Trotuari me pllaka betoni

Ndërtohet gjatë gjithë perimetrit të ndërtesës me $b=80\text{cm}$ (përfshirë bordurën)

- trotuari ndërtohet sipas përcaktimeve të projektit, me kunete.
- tubat e shkarkimit të ujrave të çatisë do të zgjaten (me bryl 90°) duke dalë jashtë trotuarit (+3-5cm) për të shkarkuar ujrat në kunetë
- pllakat e betonit të trotuarit do të jenë një ngjyrë (bezhë e mbyllur) ose të kombinuara sipas kërkesës së investitorit. Trotuari ka kunete për mbledhjen e ujrave siperfaqesorete cilat derdhen në puste me sifon në rrjetin e ujrave të zeza.

8.4. Konstruksioni metalik (baz. antene etj.)

- Është shkalla e emergjensës që do të parashikohet të bëhet me anë të profileve IPE

8.5. Shkarkimi i ujrave të çatise.

Ulluqet horizontale dhe tubat vertikale duhet të jenë sipas standartit dhe prodhimeve si panelat sandëich. Tubat vertikale do të jenë katerkëndshe, jo rrethore. Si horizontalet dhe vertikalet do të jenë prej llamarine alumini $t=1.5\text{mm}$.

Në nivelin e trotuarit, në anë të bryllave (këndi 90°) tubat vertikale kalohen në betonin e trotuarit dhe shkarkohen në kunetën e oborrit të ndërtesës e me pas në puste. Në lartësi tubat vertikale në çdo 1,5 deri 2m fiksohen me lidhje në mure me aksesor metalik të pa oksidueshem.

- lidhjet e ulluqeve horizontale me ato vertikale bëhen me aksesor të fabrikuar.

PUNOI:

ARK. ANDRIT SHEHU

ARK. ERTA CENAJ

ING. DESHIRA BOGDANI